

Jahja Drançolli

LIDHJET E BUJARËVE RAGUZANË ME DURRËSIN GJATË SHEKUJVE XIII — XIV

Procesi i formimit të patriciatit raguzan në formën përfundimtare, vërehet në aktet e shekullit XIII dhe fillimit të shekullit XIV. Mungesa e dokumenteve të shkruara në shekullin XIII, bëjnë që të vështirësohet përcaktimi i etnogjenezës së bujarisë raguzane me të gjitha veçoritë e saj, aq më parë kur dihet se fillet e këtij diferencimi social datojnë edhe shumë kohë më parë. Megjithatë, mund të themi me siguri se tregtarët e pasur ishin po ajo shtresë e cila ka pasur rol dominant në jetën publike të qytetit.

Raguza për madhësinë dhe rëndësinë e saj në radhë të parë duhet falënderuar tregtisë së zhvilluar. Tregtia dhe ekonomia në përgjithësi paraqitnin burime themelore të jetës së gjithmbarshme raguzane, veçanërisht të bujarisë. Bujaria raguzane në shekujt XIV dhe XV, ishte e përbërë nga të ashtuquajturat, gjini tregtare, të cilat paraqitnin kategorinë më të lartë të tregtarëve raguzan. Nga kjo e dhënë mund të konstatohet se historia e bujarisë raguzane, po ashtu në të njëjtën kohë edhe durrësake, duhet të ndriçohet me historinë e tregtisë së qyteteve në fjalë.

Raportet tregtare-detare të bujarisë raguzane me Durrësin ishin mjaft evidente që nga shekulli XIII. Prej kësaj kohe e mëtej hasen të dhëna të shumta lidhur me këto. Ndërkaq, qëllimi ynë në këtë punim është që t'i zëmë ngoje ato që kanë rëndësi më të madhe për ndriçimin e raporteve të gjithmbarshme të dy qyteteve më të rëndësishme të anës Lindore dhe Jugore të Adriatikut.

Në vitin 1273 në Raguzë zihet ngoje një durrësake e quajtur Basilia, uxor Petri de Marichani. Këtë onome (Basilio) e gjejmë në Raguzë edhe në vitin 1309; fjala është për një familje të njohur raguzane.¹

Nëse vërehen qytetarët e ardhur në Raguzë me qëllim përcaktimi të etnogjenezës së tyre (dukuri që nuk është evidentuar në të shumtën e rasteve nga notierët raguzanë), menjherë bie në sy dukuria e prezencës së madhe të atyre që kishin ardhur nga qytetet e pjesëve jugore të bregdetit Adriatik; në fillim të shekullit XIV ka

¹ K. Jireček, *Zbornik K. Jirečeka II*, Beograd, 1962, f. 148

pasur shumë nga Tivari, nga Durrësi, nga Ulqini, nga Zara, nga Trogiri etj.²

I biri i Dobre Simeonis de Binços (pjesëtar i familjes së njohur raguzane), Nikolla, i cili ishte viktimë e sëmundjes së murtajës në vitin 1363, është zënë nga disa herë si i angazhuar në detyra me përgjegjësi të madhe. Mirëpo, ai si duket kalon në opozitë me rastin kur emërohet si sindik për blerjen e drithërave në Apuli. Pas vdekjes së Nikollës, i biri i tij Dobruschoja, i cili ishte ende i mitur, as më vonë në moshë të pjekur nuk i shkoj përdore ta fitonte reputacionin e babait dhe të pjesëtarëve të tjerë të mëparshëm të familjes së tij. Në vitin 1380 Dobruschoja eksportoi hekur, kurse në vitin 1381 pati mosmarrëveshje me qytetin e Durrësit. Këshilli raguzan, me qëllim që ta pastronte situatën e dërgoi kancelarin e vet në Durrës.³

Lidhjet tregtare midis bujarëve raguzanë me Durrësin nuk kalonin edhe pa ndonjë mosmarrëveshje. Në këte punim do t'i zëmë nga ato më karakteristike. Në vitin 1363, qeveria Raguzane e dërgon Pashko Raninin në Durrës me qëllim ankese lidhur me mënyrën e trajtimit të raguzanëve në Durrës dhe të kërkonte që durrësakët ta kthenin një mall të plaçkitur.⁴ Mosmarrëveshje identike me Durrësin ka pasur edhe bujari raguzan Matheo de Çorçi (Matej Drzhiqi), i cili thirret nga ana e gjyqit që t'i paguajë Desës (Dessa), vejushës së Tom Vergut nga Durrësi një borxh të babait të tij, Vitut.⁵

Në vitin 1317 një pjesëtar i familjes bujare Dersa (Drzhiq), Clime de Dersa ka blerë një barkë që kapte një shumë prej 140 perperësh nga durrësaku Costa de Prochatimeno.⁶ Pjesëtar i familjes në fjalë, paraqitet edhe një herë në Durrës, në të vertetë sipas një dokumenti që mban datën e qershorit të vitit 1368, Leonard de Dersa proteston në Durrës për plaçkitjen e dy anijeve raguzane të ngarkuara me mall tekstili dhe me drithëra.⁷

U konstatua më lart se të ardhurat më të mëdha, Raguzës i sillte tregtia-detaria, ndërkaq ata që merreshin me sukses me këtë profesion e fitonin statusin e bujarit raguzan, kurse shtresa e bujarisë hapte dita më ditë shtigje të reja për pasurimin më të madh, dukuri që drejtpërdrejt kushtëzonte edhe zhvillimin e Raguzës në këtë drejtim. Kësisoj haset në shumë bujarë raguzanë, të cilët bënin tregti dhe lidhnin miqësi me durrësakët. Se në çfarë përmasash ishin të interesuar raguzanët në këtë drejtim për Durrësin ilustronë të dhënat që do t'i zëmë nga një nga ato.

² I. Manken, *Dubrovački patricijat u XIV veku*, Beograd, 1960.

³ M. Dinić, *Odluke veća dubrovačke republike I*, Beograd, 1951, f. 128, 194.

⁴ AHD, *Littera et commissione Levantis II*, f. 47—48; *Monumenta Ragusina III*, f. 252—263; J. Tadić, *Litterae et commissione Ragusinae I*, Beograd, 1935, f. 107—108.

⁵ AHD, *Littera et commissione Levantis II*, f. 120; J. Tadić, *Litterae...*, f. 378—379.

⁶ *Acta et diplomata Res Albaniae mediae aetatis I*, f. 632.

⁷ J. Tadić, *Litterae...*, f. 182—185.

Familja bujare Georgio (Zhurgoviq), e cila vjen nga Kotorri në Raguzë në fillim të shekullit XIII, bënte lidhje me Durrësin nëpërmes të pjesëtarit të vet, Georgius de Georgi me limanin e Shën Gjinit, në të vërtetë, ai në vitin 1352 emërohet si gabellatus i doganës në limanin e përmendur. Me urdhërin e tij „nauclerius Andreas condam comitis Angeli” prej Durrësi ka bartur me kondurën e tij një sasi kripe në relacion prej Vlore në Shën Gjini. Pos kësaj, ai pertitonte edhe nga angazhimi i anijeve dhe i barkave të veta me qira, këto i shfryëzonin detarët dhe peshkatarët. Në vitin 1328 Georgius de Georgi ka bërë porosinë e një barke të re për Radoslav Carenen „ita magna sicut est illa cum qua navigat Nicola de Duraço”. Radoslavi ishte i detyruar të lundronte me këtë barkë, e cila atij i sillte profit nga dy groshë në ditë.⁸ Një pjesëtar tjetër i familjes në fjalë, Vitticus Matheo de Georgio në vitin 1354 ka blerë një sasi kripe në Durrës që kapte një shumë prej 490 dukatësh.⁹

Gjinia Grade konsiderohen se pasardhës të Pasque Felicis de Grades (1280—1305). Themeluesit e kësaj gjinie bënë tregti me Durrësin dhe rrethinën e tij. Në Durrës në vitin 1313 i bëhet një ftesë gjyqësore Palme de Grades, e cila kishte të bënte me borxhin e Palmit me lartësi prej 2000 perperësh, e që duhej të shkonte në llogarinë e Paulus de Gondoles. Në vitin 1330 e lejuan represaliet e Nikollës kundër Durrësit, meqë në këtë qytet ishte marrë një sasi e parave dhe e argjendit. Kjo çështje ka mbetur e pazgjidhur gjer në vitin 1332.¹⁰ Në vitin 1333 u bë transportimi i kripës prej Durrësit në Lezhë, të cilën e blenë Junius de Lucari dhe Junius de Volcassi.¹¹ Dy vjet më vonë, Nikolla bën kontratë për të tregtuar në Serbi me „dominus Marinum Partentinum Duraçinum, notarium Marinum Ysclaum de Neapoli et iudicem Dimitrium de Bergo, procuratores nobilium virorum Thomasini Capudgrassi de Salerno capitanei et vicarii Durachii et regni Albaniae”.¹² Në vitin 1360 Nikollë Grade udhëton si i deleguar i Raguzës te Blasius Mataranga, ku do të vihet në pozitë të ndërmjetësit midis tij dhe Durrësit.¹³

Në bazë të disa dokumenteve të ruajtura, vërehet se lidhje tregtare me Durrësin ka pasur edhe një pjesëtar i gjinisë Goçe, Goze, Gozze (Guçetiq). Kjo ishte ndër familjet më të njohura të patriatit raguzan i njohur që nga shekulli i XI. Pjesëtarët e kësaj gjinie kanë luajtur rol të rëndësishëm në të gjitha fserat e jetës raguzane. Kontaktet e para të këtyre bujarëve me Durrësin datojnë prej 27. XI. 1366 kur Vite de Goçe thirret që Cordusit, kastelamit të Durrësit t’ia kthejë (paguan) një shumë parash për kripën e eksportuar „... nobili et discreto viro Vite de Goçe, nostro civii Ragusii salutem et dilectionem sinceram. Noveris quod dominus

⁸ I. Manken, *Dubrovački patricijat*, f. 204.

⁹ I. Manken, *Dubrovački patricijat*, f. 204.

¹⁰ *Monumenta Ragusina I*, f. 42; V, f. 283, 301, 369; I. Manken, *Dubrovački patricijat*, f. 282—283.

¹¹ AHD, *Diversa Cancellariae X*, f. 52’.

¹² *Monumenta Ragusina V*, f. 348.

¹³ *Monumenta Ragusina III*, f. 32.

Coradus, olim castellanus Durachi" nga ky kërkohet borxhi „pro emptione salis quam fecisti ab eo, et non observas sibi pacta que fecisti cum ipso, prout dicta pacta apparent scripta in quodam pergamenno cum subscriptione Mençii de Gallo et tuo, et cum tuo sigillo sigillata". Nga Cordusi është kërkuar që ai të vijë në Raguzë brenda një muaji, nëse ai nuk mund të vijë atëherë në vend të tij mund të vie përfaqësuesi i tij. Lidhur me ankesën në fjalë të Cordusit, Vita de Goçe lajmëron më 3. XII. 1366 se ai ishte i gaçëm të vinte në gjyq lidhur me borxhin e marrë, por me kërkesë që afatin e paraqitjes t'ia shtyjnë për 12 ditë, për shkak se mu në atë kohë kishte aq punë sa që vështirë mund të dilte në fund „... Pero respondo e prego che chome me deso termeno uno mese deslongaime die XII de pluy, che aly mye fati non pora responder nygam chome io. E qua o lasato ly mercadi e volo me spaçar de tuto e vime lo deslonge die XII, che çençe de my nygun non po responder per my chome io".⁴

Në përmbledhjen e dokumenteve të botuara „Acta et diplomata Res Albaniae mediae aetatis" haset në një dokument që bën fjalë për lidhjet e patricëve raguzanë Gleya, Gleda (Glediq) me Durrësin. Gjinia në fjalë zihet ngoje në Raguzë në shekullin e XIII, anëtarët e saj asnjëherë nuk kanë arritur në qarqe të larta të patriciatit raguzan për shkak se ajo numerikisht ishte e vogël. Një shënim nga përmbledhja e dokumenteve në fjalë na pasqyron se Durrësi ishte regjion ku bënë tregti edhe pjesëtarët e gjinisë Gleya. Në të vërtetë pjesëtari i kësaj gjinie Marcoçius de Gleya posedonte me një mall në Durrës, të cilin në vitin 1346 dëshironte ta bartte me ndonjë barkë transportuese.¹⁵

Që në fillim të shekullit XIV në radhët e bujarisë raguzane u shquan patricët e gjinisë Mençe. Sipas të dhënave burimore, edhe pse nuk mund të japim ndonjë fakt të prerë lidhur me etnogjenezën e tyre, mund të supozohet se gjinia në fjalë ka poseduar me dy degë të veta. Një degë të gjinisë në fjalë i ka takuar edhe Rosinus de Menge (sic!), i cili zihet ngoje në Durrës gjatë vitit 1243; mund të supozohet se ai ishte i biri i Mentius de Rosinos dhe vëllai i clericus Petrusi.¹⁶ Një pjesëtar i familjes Mençe në vitin 1371 bëri padi kundër qytetit të Durrësit, në ujërat e të cilit ishte sulmuar dhe plaçkitur barcosiumi i tij. Anija e tij ishte dëmtuar, po ashtu u bë plaçkitja e „barilia VI vini, salmas II panis", si dhe dy vela dhe dy lopata. Velat më vonë u kthyen, por jo edhe vena. Nicola Marini de Mençe ka kërkuar pos tjerash që qyteti i Durrësit t'i paguan dëmshpërblimin për „dampnum salis".¹⁷

Dokumentet raguzane të gjysmës së parë të shekullit XIII, pothuajse aspak nuk e zënë ngoje gjininë e njohur Petragna (Petra),

¹⁴ AHD, *Refformationes XXII*, f. 15; J. Tadić, *Litterae...*, f. 160—161.

¹⁵ *Acta et diplomata Res Albaniae mediae aetatis II*, f. 13.

¹⁶ T. Smičiklas, *Codex diplomaticus IV*, f. 186, 188.

¹⁷ AHD, *Diversa Cancellariae XXI*, f. 152; *Acta et diplomata Res Albaniae mediae aetatis II*, f. 283.

Edhe pse ka eksistuar mundësia që shumë njerëz të njohur të kohës të kontaktonin me pjesëtarët e kësaj gjinie, prapëseprapë gjer tani nuk dihet me siguri se këta ishin të lidhur në pikëpamje gjenealogjike me Petranët e vjetër. Sipas disa të dhënave kjo gjini bujarësh, në Raguzë ka ardhur në shekullin e XIII nga Durrësi. Përfaqësuesi kryesor i familjes Petrana me siguri ishte Marinus Gregorii de Petrana (1280—1344). Pos këtij, në qeverinë Raguzane ishin mjaft aktivë edhe vëllezërit e tij, si dhe disa prej fëmijëve të tij. Marinusi apo njëri prej vëllezërve të tij, respektivisht bijëve të tij, e përfaqësounin familjen Petrana në Këshillin e Vogël; në Këshillin e Rogatëve kanë pasur në deceniet e para të shekullit XIV, kryesisht nga dy, ndërkaq më vonë nga tre, bile edhe katër përfaqësues. Sipas madhësisë së familjes ky numër i të deleguarve të tyre në organe qeveritare ishte i dukshëm. Në bazë të këtij fakti mësojmë se gjinia Petrania kishte autoritet të madh në Raguzë dhe konsiderohet ndër ato më të njohurat në këte qytet. Pushtet më të madh Petranët arritën në vitin 1336 kur në Këshillin e Rogatëve fituan gjashtë vende. Mirëpo, më vonë, në këtë drejtim vie deri të rënja e dukshme. Në vitin 1343 në Këshillin e Rogatëve shohim se atyre iu ka mbetur vetëm një anëtar (Nikolla). Prej kësaj kohe e tutje, emri Petrana nuk paraqitet më në regjistrat iudices, consilarii të Këshillit të Vogël dhe Këshillit të Rogatëve. Faktor për këtë pozitë jo të lakmuar padyshim është shuarja e gjeneratës veterane të familjes në fjalë, si dhe vdekja e njëkohshme e disa anëtarëve me autoritet nga gjenerata e Petranëve të rinj. Marinusi testamentin e tij e ka përpiluar në vitin 1344, Vitaliu në vitin 1346, ndërkaq Nikollë Marini ka vdekur në vitin 1345, kurse vëllai i tij Ghergusi në vitin 1343. Theodorusi dhe Thoma kanë vdekur në vitin 1348.¹⁸ Një djalë i Theodorusit ka jetuar në gjysmën e dytë të shekullit XIV, ndërkaq Petragna i fundit Pierçe Thoma de Petragna vdiq në vitin 1365. Disa prej Petranëve të fundit ishin relativisht të rinj. Kësisoj rënia e tyre nga të gjitha pozitat autoritative në vitet katërdhjetë të shekullit XIV mund të shpjegohet vetëm nga fakti se, pozita e familjes në fjalë bie në atë kohë, kur edhe vdiqën personat më markantë të saj, dhe se anëtarët e fundit të saj nuk arritën ta ruajnë pozitën e etërve të tyre as si persona, po ashtu as në jetën politike.¹⁹

Sipas rezultateve të njohëses së shkëlqyer të Historisë së Raguzës, gjatë periudhës mesjetare, Irmgard Mankenit, mësojmë se të gjithë Petranët e shekullit XIV, rrjedhin nga Marinus Petrani i vjetër (1219—1253) dhe birit të tij Gregoriusit (1253—1280). Pos këtyre në vitin 1215 në Durrës zihet ngoje një farë Theodorus de Petronia si dhe i biri i tij Georgiusi,²⁰ si dhe në periudhën prej 1219—1235 zihet ngoje një prezbiter i quajtur Petrana fillius Theodori.²¹

¹⁸ I. Manken, *Dubrovački patricijat* f. 356—357; AHD, *Testamenta Notariae V*, f. 66.

¹⁹ I. Manken, *Dubrovački patricijat*, f. 375; AHD, *Testamenta Notariae VI*, f. 18.

²⁰ T. Smičiklas, *Codex diplomaticus III*, f. 173.

²¹ T. Smičiklas, *Codex diplomaticus III*, f. 473.

Ky prezbiter me emër Petrana me siguri ishte i biri Theodorus Petroniut. I biri i të përmendurit, Georgius de Petronia ishte me siguri Valliça f. Georgi de Petrana. Vejusha e tij, Maria, motra e Marinus de Gaymos, heq dorë në vitin 1280 „pro aptagi” nga pasuria e vajzave të Triphon Georgi Scarobogatit (një vreshtë në Zatonin raguzan), në mënyrë që të paguajë borxhin e burrit të saj.²² Lidhur me përcaktimin e etnogjenezës së bujarëve Petrania, historiani bashkëkohës Josip Luçiqi, këshilltar shkencor në Institutin Historik të Zagrebit, në një punim, konstaton se Petranët nuk kishin origjinë raguzane, dhe se ata në këtë qytet erdhën nga Durrësi që në shekullin e XIII.²³ Të dhënat e sipërme pa dyshim shpënë në zbulimin e lidhjeve midis bujarëve Petragna dhe Raguzës, respektivisht me Durrësin, ndërkaq origjina e tyre për mundësitë e njohurive tona ende mbetet e pajohur; në të vertetë mbetet të supozohet se ata ishin nga Raguzia apo Durrësi.

Duke përfunduar punimin tonë mund të thuhet se pjesëmarrës të zhvillimit të tregtisë-detarisë midis Raguzës dhe Durrësit ishin edhe pjesëtarët e këtyre gjinive raguzane: Lucari (Lukareviq),²⁴ Martinussio, Martinus (Martinushiq)²⁵ etj.

Jahja Drançolli

RELATION OF THE RAGUSA NOBLEMEN WITH DURAZZO DURING THE XIIIth — XIVth CENTURY

Summary

A considered number of the noblesse from Ragusa maintained a close relations with Durazzo during the XIIIth—XIVth century. Relations between the nobility of Ragusa and the town of Durazzo were expression of economic, strategic, cultural and religious importance, as well as the existence of the cadre od requested professions in the two above-mentioned towns.

The material of the Archives of History of Dubrovnik is considered as a main source regarding the development of relations of the Ragusa noblesse with the port of Durazzo. In the rich public records of the archives in ques-

²² *Monumenta Ragusina I*, f. 177, 180.

²³ J. Lučić, *Pomorske trgovačke veze Dubrovnika s gradovima Zet-skog i Dračkog primorja u XIII stoljeću*, Zadar, 1969.

²⁴ AHD. *Diversa Cancellariae VIII*, f. 173'.

²⁵ *Manumenta Ragusina II*, f. 360; V, f. 302, 325, 343; T. Smičiklas, *Codex diplomaticus IX*, f. 222; X, f. 163.

tion is noticed that more intensive trade and economic relations with Durazzo had members of these trade families: Basilio, Dersa, Georgio, Grade, Goçe (Goche), Greya, Mençe (Menche), Petranga, etc. According to some marginalia extracted from the documents of the Archives of History of Dubrovnik, to a new conclusion could be come in connection with a phenomenon that, except the attitude and relations of the Ragusa nobility, there could have been members of the Durazzo nobility that lived in Ragusa, as it is concretely the case with Petranga family.

hoqi nuk ishte një ngjarje që mund të kalohej në heshtje. Sado që invazorët osmanë asgjësuan pothuajse krejt dokumentacionin shqiptar të luftës, ata nuk mundën ta cenonin historinë e saj të pashkruar. Këtë histori të pashkruar në letër, por të ngulitur në kujtesë, e ruajtën fshatarët dhe qytetarët shqiptarë, të cilët kishin mbajtur mbi shpatullat e tyre, si në front ashtu dhe në prapavijë tërë peshën e rëndë të epopesë legjendare.

Me veprën e vet monumentale „Historia e jetës dhe e veprës së Skënderbeut, princit të epirotëve”, botuar në Romë midis viteve 1508—1510, Marin Barleti nuk bëri gjë tjetër veçse e hodhi në letër, me një stil klasik të përsosur, historinë e pashkruar të heroit dhe të epopesë së shek. XV, ashtu siç e tregonin dyzet vjet më vonë bashkëluftëtarët e tij dhe dëshmitarët e saj. Fakti që vepra e tij ishte një histori popullore dhe jo një apologji obortare, shpjegon arsyen përse ajo dominoi për shekuj me radhë në historiografinë botërore skënderbegiane.

Megjithatë vepra e Marin Barletit nuk mund të përmbushte *ad infinitum* kërkesat historiografike të opinionit publik botëror. Në fillim të shek. XVI kur ajo doli në dritë, kërkesat e opinionit publik nga historiografia ishin tepër modeste. Veç kësaj, humanisti shkodran nuk kishte nevojë për dokumentacion historik rigoroz që të provonte madhësinë e luftës shqiptare-turke, sepse jehona e saj ishte ende e gjallë në mbarë Evropën. Askush nuk dyshonte për heroizmin dhe dramacitetin e epopesë skënderbegiane. Për këtë arsye, M. Barletin e pranuan të gjithë, sepse u rrëmbyen jo nga stili i tij i mrekullueshëm, siç pohon F. Palli,¹ por nga vërtetësia e ngjarjes që përshkruante.

Por, siç dihet, koha bën punën e vet. Me rrjedhën e saj, epopeja shqiptare filloi t'i takonte përherë e më tepër së kaluarës së largët. Rrjedhimisht jehona e saj në kujtesën e brezave të mëvonshëm erdhi vazhdimisht duke u zbehur. Ndërkohë lindi historiografia kritike, e cila kërkonte prova për të vërtetuar madhësinë e personaliteteve dhe të ngjarjeve. Marin Barleti, sado që ishte një minierë e pasur të dhënash historike, kishte mjaft zbrazëti dhe teprime, që duheshin plotësuar dhe rregulluar. Për më tepër, vlerësimet e tij panegjirike dhe krijimet e tij retorike nuk mund të mos ngjallnin skepticizëm në radhët e historianëve kritikë dhe të lexuesve të kualifikuar. Me një fjalë, M. Barleti u kthye nga një burim absolut, në një dëshmitar relativ që duhej plotësuar, përforcuar ose korrigjuar me të dhëna të tjera të pavarura prej tij. Kështu lindi nevoja për të trokitur në dyert e arkivave dhe të bibliotekave, për të hulumtuar dhe shfrytëzuar burime dokumentare dhe letrare rreth epokës së Skënderbeut.

Në këtë drejtim, hapin e parë në historiografinë botërore skënderbegiane e kreu në mesin e shek. XVI historiani italian Paulus Jo-

¹ F. Palli, *Marino Barlezio, uno storico umanista, në: „Mèlanges d'histoire Gènèrale”*, II, Cluj 1938, f. 139—140.